

TAX Alert ***Shkurt 2011***

Amendamente ne ligjin "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar (TVSh)"

Me Ligjin nr. 10363, date 16.12.2010 jane miratuar ndryshimet e me poshtme ne Ligjin nr. 9728, date 27.04.1995 "Per tatimin mbi vleren e shtuar":

1. Furnizimi i ambalazheve dhe i materialeve, qe perdoren per ambalazhim te barnave eshte furnizim i perjashtuar per efekt TVSH-je;
2. Furnizimi i barnave dhe sherbimeve shendetsore nga institucionet shendetsore publike dhe private, eshte furnizim i tatueshem. Niveli i TVSh-se se zbatuar per keto sherbime eshte 10%.

Ky ligj hyn ne fuqi nga 01.02.2011.

Me vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 18, date 12.01.2011 jane miratuar ndryshimet e me poshtme ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 1058, date 21.10.2009 "Per kufirin minimal qe nje subjek mund te regjistrohet si tatimpagues i TVSh-se":

1. Sherbimet e ofruara nga profesione te tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, mami, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabel i regjistruar, kontabilist i miratuar, vleresues pasurie etj., pavaresisht nga qarkullimi vjetor jane subjekt i TVSh-se.

Ky vendim hyn ne fuqi nga 01.02.2011.

Amendamente ne ligjin "Per akcizat"

Me Ligjin nr. 10365, date 16.12.2010 jane miratuar ndryshimet e me poshtme ne Ligjin nr. 8976, date 12.12.2002 "Per akcizat":

1. Taksa e Akcizes mbi duhanet do te rritet nga 50 ALL/Paketa ne 70 ALL/Paketa.

Ky ligj hyn ne fuqi nga 24.01.2011.

This information is provided as a guide only and should not be construed as advice. Professional accounting and tax advice should be sought before acting upon any of the point raised in this information.

Amendamente ne ligjin "Per Tatimin mbi te Ardhurat"

Me Ligjin nr. 10343, date 28.10.2010 jane miratuar ndryshimet e me poshtme ne Ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat":

1. Tatimpaguesit individe rezident apo te vetepunesuarit rezident, qe realizojne te ardhura ne territorin e Republikes se Shqiperise, duhet te dorezojne deklarata vjetore te te ardhurave prane administrates tatimore jo me vone se data 30 Prill e vitit pasardhes. Ligji jep detaje per te dhenat qe duhet te permbaj deklarata tatimore dhe menyren e percaktimit te te ardhurave te tatueshme.
2. Shkalla tatimore e aplikushme per te ardhurat e tatueshme sipas deklarates vjetore te te ardhurave eshte 10%.

Ligji hyne ne fuqi me date 1 Janar 2011.

Me Ligjin nr. 10364, date 16.12.2010 jane miratuar ndryshimet e meposhtme ne Ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat":

1. Per shoqerite e sigurimit jane shpenzime te njohura per efekte fiskale "rezervat teknike" te krijuara ne perputhje me ligjin "Per Veprimtarit e Sigurimit dhe te Ndermjetesimit ne Sigurime dhe Risigurime", te krijuara ne perputhje me standartet e hartuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit dhe te certifikuara pa verejtje nga auditues te jashtem;
2. Per bankat jane shpenzime te njohura per efekte fiskale "Provigjionet" te krijuara ne perputhje me standartet e hartuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit dhe te certifikuara pa verejtje nga auditues te jashtem, por, ne cdo rast, pa tejkalar masen e percaktuar ne rregullat e Bankes se Shqiperise.
3. Nje entitet shqiptar, perjashtohet nga tatim fitimi per te ardhurat qe ai merr nga shperndarja e dividendit dhe fitimit te nje shoqerie ku ai eshte aksioner/ortak pavarsisht nga kuota e pjesmarrjes ne kapital apo ne te drejten e votes.

Ky ligj hyn ne fuqi nga 24.01.2011.

This information is provided as a guide only and should not be construed as advice. Professional accounting and tax advice should be sought before acting upon any of the point raised in this information.